



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA VENDORE E PËRMBARIMIT LUSHNJE

Nr. 839/7 Prot.

Lushnje, më 14.09.2026

Nr.516 Regj.

VENDIM

(PËR SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND TË DYTË TË PASURISË SË PALUAJTËSHME)

Në Lushnje, sot më datë 14.09.2026

Unë Brikena Luto, Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore me nr.516 Regj., datë 08.04.2026 në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit” nr.6068/U, datë 11.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për (titullin ekzekutiv) vendimi gjyqësor nr.6068, datë 11.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se më datën 08.04.2026 është regjistruar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e (kreditorit) Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), së bashku Urdhërit të Ekzekutimit” nr.6068/U, datë 11.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për (titullin ekzekutiv) vendimi gjyqësor nr.6068, datë 11.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë:

- Kreditor: Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Debitor: Erjon Hasan Aliaj (dorzanes Veri Spiro Prifti dhe Vjollca Tasi Prifti)
- Me objekt: Kthim shume

Lidhur me ekzekutimin e këtij tituli ekzekutiv nga ana jonë kan vazhduar procedurat ligjore sipas dispozitave të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8/2023, datë 02.02.2023 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimore Gjyqësor.*

Pasuria me nr. 112/17, volume 2, fq.60, Z.K 2617, pasuri e llojit rezervat peshku, me sipërfaqe totale 31890 m², me adresë Mazhaj, Lushnje e cilla është lënë kolateral sipas deklaratës noteriale

nr.1448 rep., 423 Kol., datë 15.08.2013 nga pronarët Veri Prifti dhe Vjollca Prifti për debitorin Erjon Aliaj) në favor të Agjensisë për Zhvillim Rural dhe Bujqësor (AZHBR) deri në shlyerjen e plotë të huas.

Me aktin teknik, Raport vlersimi të vlerusese Engjëllushe Sako ka përcaktuar vlerën e pasurisë së paluajtëshme me nr.112/17, volume 2, fq.60, Z.K 2617, pasuri e llojit rezervat peshku me sipërfaqe totale 31890 m², me adresë Mazhaj, Lushnje është 7 814 963,4 lekë.

Me shkresën nr.617 Prot., datë 03.06.2026 si dhe shkresë me nr.839 prot., datë 27.07.2026 në baze të nenit të Kodit të Proçedurës Civile është lajmëruar (debitori) Erjon Aliaj dhe dorzanësit se brenda 10 (dhjetë) ditëve të njoftimit nuk do të përmbushte detyrimin sendi i sekuestruar do të shitet në ankand.

Sipas akteve të administratuara në dosjen përmbarimore, nuk rezulton të jetë përmbushur detyrimi nga debitori.

Më datë 19.08.2026 u shpall ankandi i parë për shitjen e sendit të lënë kolateral në favor të palës kreditore . Proçeduara e ankandit të parë vazhdoi 15 ditë dhe përfundoj me mbarimin zyrtarë të datës 03.09.2026

Nga proçedura e zhvillimit të ankandit të parë si dhe proçesverbali i datës 03.09.2026 të Zhvillimit të tij rezultoi se në të gjithë afatin 15- ditorë të mbajtjes së afishimit të shitjes së sendit të paluajtshëm, ashtu si dhe ditën e zhvillimit të tij, nuk u paraqit asnjë ofertues për blerjen e sendit të paluajtshëm të përcaktuar me çmimin në shumën 6 251 970.72 lekë.

Çdo veprim i kryer nga ana jonë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv I është komunikuar palëve, duke ju dhënë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas ligjit.

Për këtë arsye: Në bazë të neneve 586,569,570 e 577 të Kodit të Proçedurës Civile, ligjit nr.8/2023, datë 02.02.2023 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbarimore Gjyqësor* si dhe udhëzimit nr.5, datë 12.12.2012 " *Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për Zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor*", unë Përmbarues Gjyqësor Brikena Luto,

VENDOSA :

1. Shpalljen e shitjes në ankand të dytë të pasurisë si më poshtë :

Pasuria nr. 112/17, volume 2, fq.60, Z.K 2617, pasuri e llojit rezervat peshku, me sipërfaqe totale 31890 m², me adresë Mazhaj, Lushnje e cilla është lënë kolateral sipas deklaratës noteriale nr.1448 rep., 423 Kol., datë 15.08.2013 nga pronarët Veri Prifti dhe Vjollca Prifti për debitorin Erjon Aliaj). Me këtë shpallje njoftohen të gjithë të interesuarit, duke i,

INFORMUAR SE :

1. Çmimi fillestar në ankandin e dytë të hapur publik është jo më i ulët se 30% (përqind) i çmimit të përcaktuar në ankandin e parë prej 6 251 970,72 lekë- 1 250 394,144 = 5 001 576,576 lekë
2. Vendi ku do të zhvillohet ankandi i dytë i hapur publik i shitjes së sendit është Zyra e Përmbarimit Lushnje, e cila gjendet në adresën: Lagja "Kongresi i Lushnjes", rruga "Vojo Kushi", pallati mbrapa kinoteatrit "Vaçe Zela", Kati II.
3. Ankandi i dytë i hapur publik për shitjen e sendit të paluajtshëm shpallet sot më datë 14.09.2026 dhe do të qëndrojë i publikuar deri më datë 14.10.2026 ditë e Mërkurë, ora 16:30
4. Dorzimi i kërkesës për pjesëmarrje në ankandin e hapur publik të dytë do të pranohet në të gjithë afatin e shpalljes dhe procesi përfundimtar i zhvillimit të ankandit do të kryhet në datë 14.10.2026, ditë e Mërkurë duke u mbyllur në orën 16:30 me mbarimin e orarit zyrtar.
5. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë në ankand është i detyruar të paraqitet personalisht dhe /ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij /saj me prokurë si dhe të dorzojë (brenda në zarf të mbyllur) në Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor (Zyrën Përmbarimore Lushnje) deri në orën 16:30, këto dokumenta:
 - a) kërkesën e tij/saj për pjesëmarrje në ankand
 - b) faturën bankare të 10 % të garancisë për pjesëmarrje në ankand (orgjinale)
 - c) Dokumentin e identifikimit (letërnjoftim ID ose Pasaportë)
6. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, në datë 16.10.2026, ditë e Mërkurë ora 16 :30 është i detyruar ti depozitoj si garanci pranë pranë Credins Bank Sh.a dega Lushnje , në numërin e llogarisë 00000511296 të Zyrës së Përmbarimit Lushnje një shumë të hollash të barabartë me 10% të çmimit të pasurisë të caktuar në shpallje. Kreditori nuk lë garanci në rast se kredia e tij kalon masën e garancisë.
7. Debitori dhe /ose përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor, si dhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil , nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.
8. Gazeta "Panorama" dhe Gazeta "Telegraf", sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i Kodit të Procedurës Civile këtë vendim detyrohen ta publikojnë 5 (pesë) ditë radhazi, në gazetatat e tyre. Për shërbimin e kryer pala kreditore merr përsipër pagimin e shumës e cila sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile i ngarkohen debitorit.

9. Ky vendim hartohet në 14 (katërbëdhjetë) kopje : 1 (një) kopje administrohet në dosjen përmbarimore, 1 (një) kopje afishohet në ambjentet e Zyrës së Përmbarimit Lushnje, 1 (një) kopje afishohet në vendin ku ndodhet ku ndodhet pasura e paluajtëshme (nëpërmjet Njesisë Administrative Allkaj, Bashkia Lushnje), 3 (tre) kopje i njoftohet debitorit dhe dorzanësve, 1 (një) kopje i njoftohet kreditorit, 4 (katër) kopje ju njoftohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Bashkisë Lushnje dhe Njesisë Administrative Allkaj, Bashkia Lushnje për afishim në ambjentet e tyre publike, 1 (një) kopje dërgohet në Drejtorinë e Përgjithëshme të Përmbarimit Tiranë si dhe 2 (dy) kopje iu njoftohen për publikim Gazetës "Panorama" dhe Gazetës "Telegraf"

KRYETARI ZYRËS

Brikena Luto





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA VENDORE E PËRMBARIMIT LUSHNJE

Nr.839/6 Prot.
Nr.516 Regj.

Lushnje, më 11.09.2026

VENDIM

“PËR CAKTIMIN E CMIMIT TË RI PËR ANKANDIN E DYTË”

Sot më datë 11.09.2026 unë Përmbaruesi Gjyqësor Shtetëror Brikena Luto bazura në procedurën e ankandit të parë publikë për ekzekutimin e Urdhërin e Ekzekutimit” nr.6068/U, datë 11.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për (titullin ekzekutiv) vendimi gjyqësor nr.6068, datë 11.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë:

- Kreditor: Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Debitor: Erjon Hasan Aliaj (dorzanes Veri Spiro Prifti dhe Vjollca Tasi Prifti)
- Me objekt: Kthim shume

Për pasurinë nr. 112/17, volume 2, fq.60, Z.K 2617, pasuri e llojit rezervat peshku, me sipërfaqe totale 31890 m², me adresë Mazhaj, Lushnje si dhe proces verbalin e datës 03.09.2026 ora 16:30 për të cilin nuk pati asnjë ofertues. Në zbatim të nenit 577 e vijues të K.Pr.Civile e si dhe udhëzimit nr.5, datë 12.12.2012 “ *Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për Zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor*”,

VENDOSA:

1. Të caktoj çmimin e ri të pasurinë nr. 112/17, volume 2, fq.60, Z.K 2617, pasuri e llojit rezervat peshku, me sipërfaqe totale 31890 m², me adresë Mazhaj, Lushnje i cili do të jetë jo më i ulët se 30 % (përqind) i çmimit të caktuar në ankandin e parë i cili ka përfunduar në datë 03.09.2026, ora :16:30.
2. Çmimi i ri i ankandit të dytë do të ulet 20 % (përqind) e çmimit të ankandit të parë dhe do të jetë në vlerën 5 001 576, 576 lekë
3. Në zbatim të pikës 10 të Udhëzimit nr.5, datë 12.12.2012 “ *Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për Zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor*” ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e caktimit të çmimit të ri dhe u nënshtrohet të njëjtave rregulla si në ankandin e parë

KRYETAR I ZYRËS

Brikena LUTO

